



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.129/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur.

A r s y e t i m

Me datën 06.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se me datën 04.10.2017 përmes një emaili subjekti politik LVV ka treguar aktivitetet e kandidatit për kryetar komune Shpend Ahmeti, ku me këtë email janë dërguar fotografi të Shpend Ahmetit gjat vizitës së tij në disa sera në të cilat ka investuar komuna. Parashtruesi i ankesës thekson se pjesë e këtyre fotografive janë edhe fëmijët e mitur. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik LVV ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 85 par 1 dhe nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik LVV, në përgjigje në ankesë të datës 07.10.2017, e mohon se se ka patur shkelje të dispozitave ligjore, i njëjti thekson se fotot me një fëmijë të mitur në të cilat pretendohet se janë publikuara nuk qëndrojnë pasi që këto foto nuk janë publikuar në asnjë medium dhe as në facebookun e kandidatit për kryetar komune Shpend Ahmeti.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se në aktivitetet e kandidatit për kryetar komune nga subjekti politik LVV, janë përfshirë edhe fëmijët e mitur, paneli gjeti se këto pretendime janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi pasi që nga fotografit që gjenden në shkresat e

lëndës dhe nga postimi i bërë nuk shihet ndonjë llogo apo shenjë e subjektit politik LVV me të cilën do të vërtetohej se i njëjti është duke bërë fushatë zgjedhore.

Pretendimet e parashtruara në ankesës se subjekti politik LVV ka shkelur nenin 85.1 të LZP-së, janë të paqëndrueshme pasi që kjo dispozitë ligjore nuk korespondon me përmbajtjen e ankesës lidhur me shkeljen e supozuar. Me këtë rast parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që ti vërtetoj pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.129/2017 më datën 10.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.